



SBASHK Arsimimi sot

Maj, 2026

Gazeta elektronike

U prezantua edhe një Udhëzues për këtë çështje SBASHK dhe Qendra e Solidaritetit mbajtën trajnim rreth mbrojtjes së sindikateve në kohë krizash



SBASHK mbajti trajnimin me temën “Mbrojtja e sindikateve në situata krizash: Një udhëzues për sindikatat në kushtet e ngushtimit të hapësirës qytetare”, ku edhe u publikua një Udhëzues për reagimin ndaj kërcënimeve që lidhen me ngushtimin e hapësirës qytetare ...(faqe 4)

Përfaqësuesit e Kosovës lartësojnë zërin e punëtorëve në Konferencën e Nivelit të Lartë të KESE-së në Vjenë



Gjatë punimeve të konferencës, z. Hykolli dhe z. Ymeri ngritën shqetësim kryesor gjendjen e vështirë të dialogut social në Kosovë...(faqe 8)

Përgatitje me kohë për një aktivitet tradicional



Krahas shumë angazhimeve në shërbim të anëtarësisë, SBASHK-u edhe këtë vit po bënë përgatitje ...(faqe 2)

Mësimdhënësit në Kosovë i duhet përmirësim i statusit shoqëror, përfshi rangimin e duhur financiar



Në intervistën e parë për gazetën “Arsimimi sot” të SBASHK-ut, Xhokli ka thënë se krahas kërkesave...(faqe 3)

SBASHK vizitoi DKA-në e Prishtinës



Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj bashkë me zyrtarin Ligjor, Blendor Shatri dhe kryetarin e Nivelit Sindikal Komunal të Prishtinës, Qamil Hajdini, vizituan Drejtorinë e Arsimit në Prishtinë dhe u takuan...(faqe 5)



Editorial

Përgatitje me kohë për një aktivitet tradicional



Krahas shumë angazhimeve në shërbim të anëtarësisë, SBASHK-u edhe këtë vit po bënë përgatitje me kohë për të realizuar aktivitetin tradicional për pushime në bregdetin shqiptar të qindra anëtarëve nga e tërë Kosova. Fillimisht për këtë aktivitet tradicional është debatuar në Këshillin Drejtues dhe janë përcaktuar edhe kriteret për përzgjedhjen e pushuesve dhe pastaj sekretari i përgjithshëm Ymer Ymeri bazuar në këto kriterë u ka dërguar kryetarëve të nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve informatën për numrin e pushuesve për çdo komunë dhe për universitetet. Ata duke u bazuar në shënimet për vitet e kaluara në takimet e Kuvendeve janë përmendur shoqatat që e kanë radhën për të caktuar pushues në këtë vit dhe

pastaj ato shënime i dorëzojnë në afatin e përcaktuar të stafit qendror dhe kështu fillon së realizuari ky aktivitet tradicional. Bazuar në rrjedhën e këtij aktiviteti gjatë viteve të kaluara edhe këtë vit pritet që çdo gjë të jetë në rregull dhe pushuesit të kthehen me përshtypje shumë të mira e se do të jetë kështu tregojnë angazhimet e stafit qendror, që krahas shumë detyrave tjera, rëndësi meritorë i kushtojnë edhe përgatitjeve me kohë për realizimin e këtij aktiviteti tradicional.

Vlen të ceket se kishte në vitet e kaluara pushues cilët janë deklaruar se për të parën herë janë në bregdetin shqiptar dhe për këtë shprehin respekt meritor për SBASHK-un. Ky realitet u jep kurajë stafit për angazhim maksimal në mënyrë që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë dhe që pushuesit të kalojnë qaste të bukura shoqëruar nga valët e qeta të bregdetit shqiptar dhe nga mikpritja e pronarit dhe të punësuarve në kompleksin hotelier “Bonita”.

Të përzgjedhurit siç jet do të jenë të ndarë në tri grupe të pushuesve dhe do të kalojnë momente të bukura në bregdetin shqiptar duke shoqëruar bisedat me humorin e lehtë e me vargjet e ndonjë kënge.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Mësimdhënësit në Kosovë i duhet përmirësim i statusit shoqëror, përfshi rangimin e duhur financiar



Mësimdhënësit në Ferizaj sikurse edhe në shumicën e komunave të Kosovës, ballafaqohen me mungesë të kushteve të punës siç janë pajisjet bashkëkohore mësimore dhe kushteve tjera të nevojshme për proces të mirëfillt mësimor.

Mirëpo, shqetësues për kryetarin e sapozgjedhur të Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar në Ferizaj, Arben Xhokli, mbetet mirëqenia e punonjësve të arsimit siç është ngritja e statusit të mësimdhënësit në shoqëri, përfshi edhe rangimin e drejtë financiar.

Në intervistën e parë për gazetën “Arsimimi sot” të SBASHK-ut, Xhokli ka thënë se krahas kërkesave për përmirësim të gjendjes materiale dhe kushteve të punës, mësimdhënësit kanë nevojë për zvogëlimin e ngarkesave administrative të cilat sipas tij shpesh ua marrin kohën nga puna e tyre kryesore – mësimdhënia.

Lidhur me gjendjen e mësimdhënëseve, statusin e tyre në shoqëri dhe kërkesat për përmirësimin e kushteve të punës, mund të lexoni në intervistën e zhvilluar me kryetarin e Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar në Ferizaj, Arben Xhokli.

SBASHK: Në zgjedhjet e rregullta sindikale në Ferizaj jeni zgjedhur kryetar i Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), si e vlerësoni zgjedhjen nga kolegët ferizajas në këtë pozitë?

Xhokli: Zgjedhjen time në krye të Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar në Ferizaj e

konsideroj si një nder të veçantë dhe një përgjegjësi të madhe. Besimi që ma kanë dhënë kolegët është vlerësimi më i mirë për angazhimin tim shumë vjeçar në arsim dhe në aktivitetet sindikale. Ky besim më obligon që të punoj me përkushtim, transparencë dhe në interes të të gjithë anëtarëve të sindikatës, pa dallime. Jam pjesë e sistemit arsimor prej shumë vitesh, ku kam ushtruar detyrën e mësimdhënësit, drejtorit të shkollës dhe kam qenë i angazhuar në procese të ndryshme që lidhen me ngritjen e cilësisë në arsim, bashkëpunimin me kolegët dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit. Përvoja ime profesionale dhe sindikale më ka ndihmuar të kuptoj nga afër sfidat me të cilat përballen mësimdhënësit dhe stafi arsimor në përgjithësi.

SBASHK: Si sindikalist në Ferizaj jeni që një kohë të gjatë dhe keni kontribuar në fushën e të drejtave të mësimdhënëseve edhe më parë. Cilat janë problemet që duhet të zgjidhen?

Xhokli: Gjatë angazhimit tim sindikal kam pasur mundësinë të jem në kontakt të vazhdueshëm me mësimdhënësit dhe stafin arsimor, prandaj i njoh nga afër sfidat me të cilat përballen. Edhe pse janë bërë përparime në disa drejtime, ende ka çështje të rëndësishme që kërkojnë zgjidhje. Në radhë të parë mbetet çështja e përmirësimit të mirëqenies së punëtorëve të arsimit, përfshirë trajtimin e drejtë financiar dhe avancimin e statusit të mësimdhënësit në shoqëri. Po ashtu, është e nevojshme të punohet më shumë në krijimin e kushteve më të mira të punës në shkolla, pajisjen me mjete bashkëkohore mësimore dhe zvogëlimin e ngarkesave administrative që shpesh ua marrin kohën mësimdhënëseve nga puna e tyre kryesore – mësimdhënia.

SBASHK: Me çka ballafaqohen mësimdhënësit e Ferizajt dhe cilat janë shqetësimet e tyre të cilat do t'i adresoni si udhëheqës i NSKAP-it në komunën tuaj?

Xhokli: Mësimdhënësit e Ferizajt, sikurse kolegët e tyre në gjithë Kosovën, përballen me një sërë sfidash që ndikojnë drejtpërdrejt në punën dhe motivimin e tyre. Një nga shqetësimet kryesore mbetet ruajtja dhe avancimi i të drejtave të tyre profesionale dhe sociale, si dhe krijimi i kushteve më të mira për zhvillimin e procesit mësimor. Si kryetar i NSKAP-it në Ferizaj, do të jem zë i çdo anëtar dhe do të punoj që çdo shqetësim i ngritur nga mësimdhënësit të trajtohet me seriozitet.

Prioritetet e mia do të jenë mbrojtja e të drejtave të punëtorëve të arsimit, respektimi i kontratës kolektive, përmirësimi i kushteve të punës. Dera ime do të jetë gjithmonë e hapur për kolegët, sepse sindikata është e fortë vetëm atëherë kur dëgjon dhe përfaqëson zërin e secilit anëtar të saj.

SBASHK: Kohën e fundit keni organizuar disa grupe të trajnimeve për mësimdhënës. Sa është interesimi i mësimdhënësve për ndjekjen e këtyre trajnimeve nga ana e mësimdhënësve?

Xhokli: Interesimi i mësimdhënësve për trajnimet ka qenë jashtëzakonisht i kënaqshëm dhe kjo tregon qartë se stafi arsimor në Ferizaj është i përkushtuar ndaj zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Në të gjitha


trajnimet që kemi organizuar kemi pasur pjesëmarrje të madhe, gjë që dëshmon vullnetin e mësimdhënësve për të përvetësuar njohuri dhe praktika të reja që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies. Sot, arsimi po përballlet me ndryshime të shpejta, veçanërisht në fushën e teknologjisë dhe metodologji bashkëkohore të mësimdhënies. Për këtë arsye, mësimdhënësit e kuptojnë se trajnimet nuk janë vetëm një obligim profesional, por një mundësi për avancim dhe përmirësim të vazhdueshëm të punës së tyre. Ajo që më gëzon më së shumti është fakti se pjesëmarrësit nuk e shohin trajnimin vetëm si mundësi për çertifikim, por si një proces nga i cili marrin ide, përvoja dhe praktika konkrete që mund t'i zbatojnë në klasë.

Gjatë muajit

SBASHK dhe Qendra e Solidaritetit mbajtën trajnim rreth mbrojtjes së sindikateve në kohë krizash, u prezantua edhe një Udhëzues për këtë çështje



SBASHK mbajti trajnimin me temën “Mbrojtja e sindikateve në situata krizash: Një udhëzues për sindikatat në kushtet e ngushtimit të hapësirës qytetare”, ku edhe u publikua një Udhëzues për reagimin ndaj kërcënimeve që lidhen me ngushtimin e hapësirës qytetare.



Tryezën e hapi kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i cili e falënderoi zyrtarin e lartë të programit në Qendrën e Solidaritetit në Washington-ShBA, Jeff Wheeler, qendër kjo e cila e mbështeti këtë trajnim.



Jasharaj tha se e falënderon Wheeler për kontributin e tij duke ardhë nga ShBA për të bartur përvojat e tij se si të sillemi në situata krizash dhe t'i përballojmë krizat e kohës.



“SBASHK kishte sfida të ndryshme si ajo në vitin 2022 ku u përballëm me një grevë dhe sulme të ashpra, dhe i tejkaluam ato sfida falë përvojës dhe unitetit që e kishim. E falënderoj Qendrën e Solidaritetit për këtë mbështetje dhe kjo e ka arsyetuar më së miri atë thënien ‘Miku i mirë në ditë të vështira’”, tha Jasharaj. Ai e falënderoi edhe Bruna Hylviun dhe Kejsi Gaxhën nga Qendra e Solidaritetit të cilat e mbështetën SBASHK-un në shumë aktivitete sindikale.



Kryetari Jasharaj i dhuroi Wheelerit edhe një dhuratë nga SBASHK-u.

Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri tha se udhëzuesi që po e paraqet Qendra e Solidaritetit do t'i shërbej SBASHK-ut në veprimet e saj, derisa shtoi se kështu edhe kishte vepruar gjatë periudhës 5 javore të grevës. “Kështu edhe jemi vepruar gjatë periudhës 5 javore kur kemi pas presion të jashtëzakonshëm nga Qeveria dhe individë të caktuar të shtyrë nga Qeveria të cilët janë munduar t'i bindin sindikalistët për thyerje të grevës. Por falë këtyre miqve, përkrahjes dhe falë komunikimit të vazhdueshëm në Nivelet Sindikale Komunale të Arsimit, nuk kanë mundur të na thyejnë grevën dhe e kemi realizu atë. Është për t'u vlerësu shumë ndihma që e kemi nga Qendra e Solidaritetit”, tha ndër të tjera Ymeri.



Kurse vet zyrtari i Qendrës së Solidaritetit për Evropë, Jeff Weehler, tha se Kosova është ndër vendet e preferuata të tij. “Kam dëgjuar kaq shumë gjëra të mira për ju. Jam i lumtur që e kam mundësinë të jem këtu. Unë jam këtu për t'i mbështetur Kejsin dhe Brunën në aktivitetet e tyre në mbrojtje të sindikatave.

Atdhe Hykolli nga BSPK tha se organizata që ai e udhëheq ka kaluar nëpër situata krizash të ndryshme por sipas tij falë mbështetjes së Qendrës së Solidaritetit, ato janë tejkaluar

SBASHK vizitoi DKA-në e Prishtinës



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj bashkë me zyrtarin Ligjor, Blendor Shatri dhe kryetarin e Nivelit Sindikal Komunal të Prishtinës, Qamil Hajdini, vizituan Drejtorinë e Arsimit në Prishtinë dhe u takuan me drejtorin

Arianit Elshani, pas pranimit të detyrës së tij në këtë pozitë. Kryetari Jasharaj i uroi detyrën e re në emër të SBASHK-ut, drejtorit Elshani duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në shërbim të arsimit në kryeqytet. Për çështje në arsim folën edhe zyrtari Ligjor, Blendor Shatri dhe kryetari i NSKAP-it, Qamil Hajdini të cilët e informuan drejtorin Elshani për çështjet aktuale me arsim për t'u ndalur më shumë në çështjet në arsimin parauniversitar të Prishtinës.

Ata bashkëbiseduan me drejtorin Elshani për mësimin tërëditor, për rregulloren për arsimin parauniversitar të kryeqytetit, për digjitalizimin e shkollave e për çështje tjera aktuale për çka të dyja palët u pajtuan që të vazhdojnë me bashkëpunimin në shërbim të arsimit parauniversitar në kryeqytet. Të dyja palët vendosen që të vazhdohet me takimet në mënyrë që bashkëpunimi të vazhdojë edhe më tutje.

ZGJEDHJET SINDIKALE

Në kuadër të zgjedhjeve të përgjithshme në SBASHK gjatë muajit maj u mbajtën shtatë kuvende zgjedhore komunale

SBASHK gjatë majit zgjodhi shtatë kryetarë të NSKAP-it

Edhe muaji maj në SBASHK ka vazhduar me frymën e zgjedhjeve të rregullta sindikale të cilat po mbahen në Nivelin Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar e të cilat pritet të vazhdojnë deri në mbajtjen e Kongresit të Përgjithshëm të SBASHK-ut dhe zgjedhjen e kryetarit të ri. Vetëm gjatë muajit maj janë mbajtur shtatë kuvende zgjedhore në Nivelin Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP) në komuna të ndryshme të Kosovës.

Zgjedhjet sindikale në Drenas-kryetar u rizgjodh Ilaz Dervishi, nënkryetare Zejnepe Gjoshi

Qysh në fillim të majit zgjedhjet u mbajtën në Drenas, ku

u rizgjodh kryetar, Ilaz Dervishi dhe nënkryetare Zejnepe Gjoshi, u zgjodhën edhe kryesia e re e NSKAP-it të Drenasit, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Gjatë procesit zgjedhor në Drenas ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: Kryetari Rrahman Jasharaj dhe Kryetari i komisionit statutar, Blendor Shatri. Procesi zgjedhor në Drenas u zhvillua në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë. Kryetar i NSKAP-it të Drenasit u rizgjodh Ilaz Dervishi, ndërsa nënkryetare, Zejnepe Gjoshi.



Kuvendi i NSKAP-it të Drenasit propozoi që kryetari z. Rrahman Jasharaj të shpallet kryetar nderi. Kurse i propozoi kandidaturën e z. Blendor Shatrit për Kryetar të SBASHK-ut si dhe propozoi që z. Ymer Ymeri t'i vazhdohet edhe një mandat si Sekretar i Përgjithshëm i SBASHK-ut.

Zgjedhjet sindikale në Obiliq-kryetare u rizgjodh Luljeta Boshnjaku, nënkryetar Fuad Hashani

Pas Drenasit zgjedhjet sindikale komunale u mbajtën edhe në Obiliq, ku kryetare u rizgjodh Luljeta Boshnjaku, ndërsa nënkryetar Fuad Hashani.



Edhe në Kuvendin Zgjedhor të Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar në Obiliq u zgjodhën kryetarja, nënkryetari, kryesia e re e NSKAP-it të Obiliqit, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.



Gjatë procesit zgjedhor në Obiliq ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: Kryetari Rrahman Jasharaj dhe Kryetari i komisionit statutar, Blendor Shatri. Procesi zgjedhor në Obiliq u zhvillua në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë. Kuvendi i NSKAP-it të Obiliqit i propozoi kandidaturën e z. Blendor Shatrit për Kryetar të SBASHK-ut si dhe propozoi që z. Ymer Ymeri t'i vazhdohet edhe një mandat si Sekretar i Përgjithshëm i SBASHK-ut.



Zgjedhjet sindikale në Gjakovë-kryetar u zgjodh Visar Shehu, nënkryetare Mirdita Ademi

Gjatë muajit maj, procesi zgjedhor përfundoi edhe në Gjakovë. Në zgjedhjet sindikale në Gjakovë, kryetar u zgjodh Visar Shehu, ndërsa nënkryetare Mirdita Ademi ndërsa Kuvendi Zgjedhor zgjodhi edhe kryesinë e re të NSKAP-it të Gjakovës, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.



Gjatë procesit zgjedhor në Gjakovë ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: Kryetari Rrahman Jasharaj dhe Kryetari i komisionit statutar, Blendor Shatri. Procesi zgjedhor në Gjakovë u zhvillua në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë. Kuvendi i NSKAP-it të Gjakovës i propozoi kandidaturën e z. Blendor Shatrit për Kryetar të SBASHK-ut si dhe propozoi që z. Ymer Ymeri t'i vazhdohet edhe një mandat si Sekretar i Përgjithshëm i SBASHK-ut.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Zgjedhjet sindikale në Malishevë-kryetar u zgjodh Naser Krasniqi, nënkryetare Valentina Berisha Mazreku. Zgjedhje sindikale komunale gjatë majit pati edhe në Malishevë, ku u zgjodh kryetar Naser Krasniqi, ndërsa nënkryetare Valentina Berisha Mazreku. Në Kuvendin Zgjedhor të Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), u zgjodhën kryetari, nënkryetarja, kryesia e re e NSKAP-it të Malishevës, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.




Gjatë procesit zgjedhor në Malishevë ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: Kryetari Rrahman Jasharaj dhe Kryetari i komisionit statutar, Blendor Shatri. Procesi zgjedhor në Malishevë u zhvillua në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë. Kuvendi i NSKAP-it të Malishevës, i propozoi kandidaturën e z. Blendor Shatrit për Kryetar të SBASHK-ut.



Zgjedhjet sindikale në Suharekë-kryetar u rizgjodh Nazim Gashi, nënkryetare Xhylsime Kuçi. Edhe Suhareka organizoi zgjedhjet sindikale të nivelit komunal, ku kryetar u rizgjodh Nazim Gashi, ndërsa nënkryetare Xhylsime Kuçi. Në Suharekë u mbajt Kuvendi Zgjedhor i Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), ku u zgjodhën kryetari, nënkryetarja, kryesia e re e NSKAP-it të Suharekës, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.



Gjatë procesit zgjedhor në Suharekë ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: Kryetari Rrahman Jasharaj dhe Kryetari i komisionit statutar, Blendor Shatri. Kuvendi i NSKAP-it të Suharekës, i propozoi kandidaturën e z. Blendor Shatrit për Kryetar të SBASHK-ut si dhe propozoi që z. Ymer Ymeri t'i vazhdohet edhe një mandat si Sekretar i Përgjithshëm i SBASHK-ut.



Zgjedhjet sindikale në Skenderaj-kryetar u rizgjodh Shpend Rexha, nënkryetare Fatlume Mehmeti. Ndërsa në javën e fundit të muajit maj zgjedhjet u mbajtën edhe në Skenderaj, ku kryetar u rizgjodh Shpend Rexha, ndërsa nënkryetare Fatlume Mehmeti. Në Skenderaj u mbajt Kuvendi Zgjedhor i Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), ku u zgjodhën kryetari, nënkryetarja, kryesia e re e NSKAP-it të Skenderajt, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.



Gjatë procesit zgjedhor në Skenderaj ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: Kryetari Rrahman Jasharaj dhe Kryetari i komisionit statutar, Blendor Shatri. Procesi zgjedhor në Skenderaj u zhvillua në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë.



UDHËTIMET JASHTË VENDIT

Përfaqësuesit e Kosovës lartësojnë zërin e punëtorëve në Konferencën e Nivelit të Lartë të KESE-së në Vjenë



Në ambientet e ndërtesës ÖGB-Catamaran në Vjenë të Austrisë, zhvilloi punimet Konferenca e Nivelit të Lartë e Shoqërisë Civile BE-Ballkani Perëndimor, e organizuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social Evropian (KESE), me temën qendrore “Besimi dhe Partneriteti në Zemër të Zgjerimit të BE-së”. Në këtë ngjarje të një rëndësie të veçantë për rrugëtimin evropian të rajonit, Republika e Kosovës u përfaqësua në mënyrë të denjë nga një delegacion i përbërë nga përfaqësues të shoqërisë civile, sindikatave dhe odave të bizneseve.



Në kuadër të përfaqësimit të punëtorëve dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre, nga radhët e sindikatave morën pjesë Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), z. Atdhe Hykolli, si dhe Sekretari i Përgjithshëm i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit,

Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), z. Ymer Ymeri.



Gjatë punimeve të konferencës, z. Hykolli dhe z. Ymeri ngritën shqetësim kryesor gjendjen e vështirë të dialogut social në Kosovë. Ata potencuan para të pranishmëve sfidat e mëdha me të cilat përballen organizatat sindikale në vend, mungesën e një partneriteti të qëndrueshëm dypalësh dhe trepalësh, si dhe nevojën emergjente për një angazhim më serioz të institucioneve në funksionalizimin e plotë të mekanizmave të dialogut social. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të punëtorëve kosovarë në këtë konferencë rikonfirmoi faktin se Kosova është tashmë pjesë aktive e strukturave dhe diskutimeve të Këshillit Ekonomik dhe Social Evropian (KESE).

Ky organizim shërbeu si një platformë jetike për të treguar se zëri i punëtorëve nga Kosova nuk mbetet i izoluar, por po integrohet me sukses në takimet dhe forumet e nivelit rajonal dhe evropian. Përfshirja e drejtpërdrejtë në këto tryeza të nivelit të lartë – ku të pranishëm janë zyrtarë të lartë të BE-së, eurodeputetë dhe krerë të federatave sindikale evropiane, si Presidenti i KESE-së, Séamus Boland, dhe Presidenti i Konfederatës Evropiane të Sindikatave, Wolfgang Katzian – u jep një peshë të jashtëzakonshme kërkesave tona. Ajo dëshmon se integrimi evropian i Kosovës kalon pashmangshëm përmes fuqizimit të shoqërisë civile, partnerëve socialë dhe respektimit të standardeve evropiane në punë dhe dialog social

Në Tiranë u mbajt tryezë e Rumbullakët e ETUCE-s

SBASHK me përfaqësim të barabartë evropian dhe zë të fuqishëm për ngecjet në dialogun social në Kosovë



Në Tiranë, i mbajti punimet dyditore Tryeza e Rumbullakët e Evropës Qendrore dhe Lindore (Central Eastern European Roundtable), e organizuar nga Komiteti Sindikal Evropian për Edukim (ETUCE). Ky forum i nivelit të lartë ndërkombëtar bëri bashkë krerët dhe liderët e sindikatave të arsimit nga mbarë rajoni dhe Evropa për të trajtuar reformat strukturore, mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve arsimorë dhe strategjitë e reja të zhvillimit sindikal. Në këtë tryezë të rëndësishme, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Republikës së Kosovës (SBASHK) u përfaqësua në nivelin më të lartë zyrtar nga Nënkryetarija, znj. Vjollca Shala, dhe Sekretari i Përgjithshëm, z. Ymer Ymeri.



Përfaqësim i Barabartë dhe Dinjitoz në Forumet Evropiane

Pjesëmarrja e SBASHK-ut në këtë tryezë rikonfirmoi edhe një herë pozicionin e saj të konsoliduar si anëtare me të drejta të plota dhe plotësisht e barabartë në familjen e sindikatave evropiane të arsimit. Delegacioni i Kosovës qëndroi krah për krah direkt me përfaqësuesit e shteteve të tjera evropiane, duke dëshmuar se zëri i mësimdhënësve të Kosovës dëgjohej me respekt të plotë dhe ndikon direkt në hartimin e politikave të përbashkëta të ETUCE-s.



SBASHK-u Aktiv: Ngritet zëri për problemet me Dialogun Social në Kosovë

Gjatë sesioneve të para, përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë qenë jashtëzakonisht aktivë, duke shfrytëzuar këtë platformë evropiane për të shpërfaqur realitetin me të cilin përballen punonjësit e arsimit në Kosovë. Në mënyrë të veçantë, znj. Shala dhe z. Ymeri kanë ngritur shqetësimet serioze lidhur me ngecjet e theksuara në dialogun social në Kosovë, duke vënë në dukje barrierat dhe mungesën e gatishmërisë së mjaftueshme nga ana e autoriteteve qeveritare për të zhvilluar një dialog të mirëfilltë, transparent dhe kuptimplotë. Delegacioni i SBASHK-ut ka bërë të qartë para të pranishmëve se injorimi i kërkesave legjitime të sindikatës dhe bllokimi i kanaleve të komunikimit dëmton drejtpërdrejt jo vetëm mirëqenien e mësimdhënësve, por edhe stabilitetin e vetë sistemit arsimor në Kosovë.



Fjalimet Kryesore dhe Tematikat e Trajtuara sipas Strukturës Zyrtare

Punimet e Tryezës u hapën me fjalimet kryesore nga

krerët e ETUCE-s dhe sindikatave nikoqire, ku u trajtuan dhe po trajtohen shtyllat kryesore si më poshtë:
Hapja dhe Kornizimi i Tryezës: Ceremonia nisi me fjalën përshëndetëse të John MacGabhann, President i ETUCE-s, dhe krerëve nikoqirë nga Shqipëria, Nevruz Kaptelli (President i SPASH) e Shpëtim Brahaj (Kryetar i FSASH). Mjaft i rëndësishëm ishte fjalimi i Jelmer Evers, Drejtor në ETUCE, i cili bëri kornizimin e plotë të tryezës së rrumbullakët, duke hapur rrugën për prezantimet pasuese mbi Politikën Evropiane të Edukimit në kuadër të Fondacionit Evropian të Trajnimit (ETF). Fjalimet Institucionale: Në emër të institucioneve të Republikës së Shqipërisë, pjesëmarrësit e pranishëm u përshëndetën nga Zëvendësministria e Arsimit, znj. Orjana Osmani, si dhe Kryetari i Komisionit Parlamentar për Edukim, z. Luciano Boçi.



Të Drejtat Sindikale sipas ILO-s: Një vëmendje e veçantë iu kushtua mbrojtjes së të drejtave dhe lirive sindikale përmes prezantimeve të detajuara nga Gocha Aleksandria (përfaqësues i ILO-ACTRAV — Organizata Ndërkombëtare e Punës) dhe Dominique Marlet (përfaqësuese e Education International).

SBASHK në Konferencën vjetore të Rrjetit Evropian të Udhëheqjes së Arsimit - ELNE 2026 në Bruksel



SBASHK gjatë muajit maj kishte marrë pjesë edhe në Konferencën ELNE 2026 të organizuar nga ELNE në bashkëpunim me ETUCE në Bruksel, duke përfaqësuar interesat e punëtorëve të arsimit nga Kosova në nivel evropian dhe duke forcuar bashkëpunimin me sindikatat homologe.

Në këtë Konferencë të rëndësishme SBASHK u përfaqësua nga Vjollca Shala, Nënkryetare e SBASHK-ut si dhe Nezafete Jakupi, Zyrtare në SBASHK.



Konferenca vjetore ELNE 2026 kishte mbledhë aktorë të arsimit nga e gjithë Evropa për të eksploruar se si mund të forcohet në praktikë udhëheqja bashkëpunuese, duke u bazuar në perspektivat, nevojat dhe rolet e grupeve të ndryshme të interesit.

Përmes një kombinimi të dialogut politik, kontributit të ekspertëve dhe sesioneve ndërvepruese, konferenca kishte lidhë prioritetet evropiane me realitetet kombëtare dhe lokale.

Konferenca kishte shqyrtuar zhvillimet e fundit evropiane, përfshirë rishikimin afatmesëm të EEA-së (2025) dhe Monitorimin e Arsimit dhe Trajnimeve.

Në konferencë ishin identifikuar kushtet kryesore dhe mekanizmat politikë që mbështesin qeverisjen efektive dhe gjithëpërfshirëse në arsim për drejtues dhe aktorë të ndryshëm arsimorë.



Nënkryetarja Vjollca Shala kishte kontribuar në diskutimet evropiane për udhëheqje bashkëpunuese, mbi politikën gjithëpërfshirëse në arsim dhe rolin e dialogut social në avancimin e të drejtave të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

SBASHK vazhdon të mbetet e përkushtuar në avancimin e arsimit gjithëpërfshirës, mbrojtjen e të drejtave të mësimitdhënësve dhe nxënësve, si dhe në forcimin e rolit të sindikatave në proceset vendimmarrëse në nivel kombëtar dhe evropian.

SBASHK në Dublin – Strategjitë Sindikale për Inteligjencën Artificiale në Arsim

Në një periudhë ku teknologjia po transformon me shpejtësi themelet e arsimit, përfaqësuesit e SBASHK-ut, Nënkryetarja Vjollca Shala dhe Sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri, kishin marrë pjesë në punëtorinë ndërkombëtare me temë: “Negociatat kolektive mbi Inteligjencën Artificiale dhe Edukimin: Ndërtimi i një strategjie sindikale”.



Ky aktivitet ishte zhvilluar në ambientet e Ashling Hotel Dublin dhe kishte mbledh përfaqësues të sindikatave të arsimit nga mbarë Evropa nën organizimin e ETUCE-së (Komiteti i Sindikatave Evropiane të Arsimit). Mesazhet Kryesore nga Hapja e Punëtorisë



Kryetari i ETUCE, John MacGabhann, hapi punëtorinë me një thirrje të qartë për mbrojtjen e rolit të mësuesit:


- Autonomia e Mësuesit: AI duhet të shihet si një mjet ndihmës, por mësuesi duhet të mbetet gjithmonë “në krye” dhe të mbajë autonominë e plotë pedagogjike.
- Vlerat Demokratike: Ekziston një shqetësim mbi ndikimin e korporatave të mëdha teknologjike (veçanërisht nga SHBA), vlerat e të cilave jo gjithmonë

përputhen me sistemet tona demokratike të arsimit.

- Misioni i Takimit: Qëllimi është që AI të bëhet një pikë kyçe e negociatave kolektive, duke fuqizuar sindikatat që të mbrojnë fëmijët dhe sistemet arsimore nga ndikimet e dëmshme.

Pikat Kyçe të Agjendës dhe Angazhimi i SBASHK Pjesëmarrja e SBASHK në këtë agjendë intensive dëshmon përkushtimin e sindikatës për të qenë në hap me zhvillimet globale:

- Përditësime Kombëtare: Diskutime mbi aksionet e negociatave kolektive nga vende si Franca, Islanda, Skocia dhe Suedia.
- Gjetjet e Survey-t të ETUCE: Prezantimi i të dhënave shkencore mbi ndikimin e AI në arsim nga studiues të universiteteve të Aarhus dhe Danimarkës Jugore.
- Punë në Grupe: Ymer Ymeri dhe Vjollca Shala janë pjesë e grupeve punuese për interpretimin e gjetjeve dhe ndërtimin e fuqisë sindikale duke përdorur kornizën “Your Turn 2” të Prof. Howard Stevenson.
- Strategjia e Ardhshme: Takimi përmbylet me hapat e radhës në nivel Evropian dhe Global, ku SBASHK do të ketë mundësinë të harmonizojë strategjitë e saj me ato të Education International (EI).



Rëndësia e Pjesëmarrjes

Prania e drejtuesve të SBASHK në këtë forum është jetike për të siguruar që punonjësit e arsimit në Kosovë të kenë një zë në tavolinën e negociatave për dixhitalizimin. Ky trajnim u ofron atyre mjetet e nevojshme për:

1. Lobim efektiv për rregullimin e përdorimit të AI në shkolla.
2. Mbrojtjen e vendeve të punës dhe dinjitetit profesional të mësuesve.
3. Krijimin e politikave që mbrojnë të dhënat dhe vlerat arsimore nga ndikimet e jashtme tregtare

TRAJNIMET

SBASHK organizoi dhjetëra grupe të trajnimit gjatë muajit maj 2026


SBASHK mbajti testet për pesë grupe të trajnimit në vikendin e fundit të majit, organizoi edhe dhjetëra grupe tjera të trajnimit



Vikendin e fundit të majit, SBASHK mbajti testet për pesë grupe të mësimdhënësve të cilët e kishin përfunduar me sukses trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” moduli 1 dhe 2, ndërkohë gjatë gjithë muajit organizoi edhe dhjetëra grupe tjera të trajnimit, disa prej të cilave po vazhdojnë ende.



Të dielën e 31 majit SBASHK mbajti testet për tri grupe të trajnimit, një në Obiliq në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”-moduli 2, i cili ishte udhëhequr nga trajnerja e përzgjedhur nga SBASHK, Blerona Ahmeti, si dhe dy grupe në Gjilan në po të njëjtin program në modulën e parë, e të cilat ishin udhëhequr nga trajnerja Ibadete Limoni.



Ndërkohë, teste u organizuan edhe në shtunën në Prishtinë për dy grupe të mësimdhënësve të cilët i përfunduan trajnimet në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, moduli 1 dhe 2, nën udhëheqjen e trajnerëve Nexhmedin Gruda, respektivisht Dorentinë Demaku.



Të shtunën në 30 majit SBASHK filloi po ashtu me dy grupe të trajnimit, një në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, moduli 1 dhe një në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”.




Në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” një grup i trajnimit filloi në Mamushë, i cili po udhëhiqet nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Fahri Morina.



Ndërkohë, në Pejë trajnimin e filloi një grup i mësimdhënësve në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, i cili po udhëhiqet nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Ilir Gashi.

Ndërkohë, gjatë muajit maj SBASHK kishte organizuar edhe 9 grupe tjera të trajnimit e të cilat kishin përfshirë disa komuna të ndryshme të Kosovës.



Të shtunën e 16 majit në Prizren kishin filluar 5 grupe të trajnimit, një në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”-moduli 2, me trajner Arben Zymeri. Po ashtu, dy grupe kishin filluar në programin e trajnimit, “Aplikimi i programeve

kompjuterike në mësimdhënie"-moduli 1 me trajnerët e përcaktuar nga SBASHK, Albert Samadraxha dhe Naser Kastrati. Si dhe dy grupe kishin filluar në programin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social" me trajnerët e përzgjedhur nga SBASHK, Arlinda Lamaj dhe Skender Gashi.



SBASHK me një grup të trajnimit në programin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social" kishte filluar edhe në Vushtrri me trajnerin Zahir Kastrati si dhe në Obiliq në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie"-moduli 2 me trajneren e përcaktuar nga SBASHK, Blerona Ahmeti.



Të shtunën SBASHK kishte filluar edhe me dy grupe të trajnimit në Podujevë, një në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie"-moduli 1 me trajner Muhamet Shabani si dhe një grup në programin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social" me trajneren e përcaktuar nga SBASHK, Nora Haliti.



Ndërkohë, një javë më parë SBASHK kishte mbajtur edhe testin për një grup të mësimdhënësve në Istog, të cilët e kishin përfunduar me sukses trajnimin në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie". Testi ishte administruar nga zyrtari Ligjor në SBASHK, Blendor Shatri. Ndërsa trajnimi ishte udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Burim Krasniqi.



Po në vikendin e 9 dhe 10 majit, SBASHK kishte filluar edhe me dy grupe të reja të trajnimit në programin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social", një në Prishtinë dhe një në Rahovec.



Grupi i trajnimit në Prishtinë ishte udhëhequr nga trajneri Afrim Gashi, derisa të gjitha grupet e trajnimit të cilat po mbaheshin në Prishtinë, i kishte monitoruar edhe udhëheqësi i Divizionit për Zhvillim Profesional dhe Licencim të Personelit Arsimit në MASH, Osman Beka. Ndërkohë një grup i trajnimit në po këtë program ishte mbajtur edhe në Rahovec nën udhëheqjen e trajnerit të përcaktuar nga SBASHK, Gani Kryeziu.



Po ashtu, qysh në fillim të majit, SBASHK kishte organizuar testet edhe për katër grupe të mësimdhënësve të cilët më parë e kishin filluar trajnimin në program "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie". Të dielën e 3 majit SBASHK kishte organizuar testet për dy grupe të trajnimit në Ferizaj të cilat u administruan

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

nga Sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, Ymer Ymeri, dhe zyrtarja Shukrie Gori Markovic. Ndërkohë, trajnimet ishin udhëhequr nga trajnerët e përzgjedhur nga SBASHK, Arsim Qalaj dhe Xhemil Halili.



Të pranishëm gjatë mbajtjes së testimit ishin kryetari i NSKAP-it për Ferizaj, Fejzullah Vranofci, anëtarja e Kryesisë së SBASHK-ut, Hanife Salihu, si dhe anëtari i Kryesisë së NSKAP-it në Ferizaj, Arben Xhokli.



Kurse në Podujevë, SBASHK kishte mbajtur testet për dy grupe të tjera të mësimdhënësve në të njëjtin program, “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, të cilët ishin udhëhequr nga trajnerët e përzgjedhur nga SBASHK, Blerim Hyseni dhe Leotrim Sadiku.

Testet në Podujevë u administruan nga zyrtari ligjor i SBASHK-ut, Blendor Shatri, ndërsa i pranishëm për t’u kujdesur për mbarëvajtjen e testimit ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Podujevë, Fadil Halimi.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture